



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Proçes verbal

Sot me datë 10.12.2024 ora 13:30 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit Bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak.

Të pranishëm janë:

Z. Oltion Luli
Znj. Irena Shala
Znj. Valjeta Bajraktari
Z. Gjergj Sokoli
Z. Edmond Ndou
Znj. Violeta Perndrecaj

Mungon:

Z. Blendi Gjylbegaj

Vijohet me citimin e rendin të ditës, që parashikohet për mbledhjen ardhshme të Këshillit Bashkiak. pjesë kjo që kryhet nga kryesia e Këshillit. Diskutohet mbi pikat e parashikuara të rendit të ditës, për të cilat Znj. Shala dhe Znj. Bajraktari shprehen se materialet për miratimin e buxhetit kanë nevojë për më shumë kohë që të shqyrtohen nga ana e tyre. Gjithashtu diskutohet për datën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, ku Z. Luli propozon si datën 19.12.2024 për mbledhjen. Përsëri Znj. Shala dhe Znj. Bajraktari shprehen se data e propozuar është e papërshtatshme pasi bëhet fjalë për buxhetin e Bashkisë. Ato propozojnë datën 27.12.2024 për zhvillimin e mbledhjen. Z. Luli hedh në votim propozimet e bëra dhe me 3 vota pro dhe 2 kundër vendoset për datën 19 dhjetor 2024. Mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak do të mbahet të enjten datë 19.12.2024 ora 17:00 me rend dite si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Nëntor 2024"*.
2. Pr/Vendim: *"Për miratimin e nivelit të bursave për nxënësit e viteve të para, viteve të dyta e lart të shkollave të mesme për vitin shkollor 2024-2025"*.
3. Pr/Vendim: *"Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës"*.

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti